



Titulli i projektit

Riorganizimi i QEK (Qendra e Edukimit dhe Komunikimit).

Tipi i projektit

Projekte që mobilizohen shpejt

Vendndodhja  
e projektit

Bashkia Peshkopi

Buxheti i paravlerësuar

15,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza  
e problemit/eve

QEK (Qendra e Edukimit dhe Komunikimit) është një nga ambientet dhe institucionet më të bukura dhe interesante në Peshkopi. Kjo qendër është krijuar nga mbështetja e DANIDA-s, si qendër që do t'i shërbejë komunitetit për zhvillimin social, duke krijuar ambientin e përshtatshëm për edukimin, komunikimin e grupeve të ndryshme, zhvillimin e medias lokale, nxitjen e dialogut të pushtetit lokal me komunitetin, etj.. Grupi kryesor i synuar i kësaj qendre janë të rinjtë, gratë, intelektualët, shoqëria civile dhe grupet komunitare. Qendra ia ka arritur të përbushë misionin e saj, jo vetëm gjatë periudhës së mbështetjes nga DANIDA, por edhe pas saj, pasi kishte hapësira për gjenerim të ardhurash, sidomos nga dhënia me qera e ambienteve të saj për aktivitete të ndryshme. Buxhetet e kufizuara të bashkisë, pengesat ligjore, sidomos në aspektin e taksave dhe konkurrenca në rritje nga sektori privat, kanë bërë që QEK ta humbasë vitalitetin e funksionit të saj, duke iu reduktuar hapësirat për gjenerim të ardhurash, sidomos nga qeratat. Misioni i QEK është vështirësuar edhe si pasojë e mos funksionimit të Bordit Drejtues, shkurtimit të stafit, dhënies me qera të një pjesë të ambienteve që nuk gjeneruan vlerë të shtuar dhe një shpëputje e izolim nga grupet e interesit. Të gjitha këto sollën uljen e numrit të aktiviteteve dhe e kthyen qendrën në një institucion që rëndon në buxhetin e bashkisë, pa sjellë ndonjë përfitim social apo ekonomik.

Riorganizimi i QEK, duke vënë në funksion organet drejtuese, duke u hapur me grupet e interesit dhe duke lejuar futjen e ideve dhe mjeteve inovative e të thjeshta, do ta bënin QEK një qendër të rëndësishme për zonën funksionale të Dibrës dhe komunitetin dibran.

Qëllimi/et specifik  
të projektit

Objekti i përgjithshëm: Krijimi i mundësive për demokratizimin e shoqërisë dibrane, duke krijuar hapësirën dhe lehtësirat e nevojshme për komunitetin dibran, rininë, gratë, shoqërinë civile, median, që të ushtrojnë misionin e tyre.

Objekti specifik: Riorganizimi i QEK me një platformë, program, organe drejtuese, sistem menaxherial dhe riorganizim të hapësirave të objektit në funksion të nismave të grupeve të interesit (rinisë, gruas, shoqërisë civile, medias, grupeve komunitare), të cilat kanë dalë nga një proces i hapur dialogues ndërmjet tyre, brenda vitit 2015.



## Rezultatet e pritshme dhe treguesit

Rezultati i pritshëm 1: QEK ka zgjedhur organet drejtuese dhe ka hartuar programin 1-vjeçar të aktiviteteve me pjesëmarrjen aktive të grupeve të interesit.  
Rezultati i pritshëm 2: Grupet komunitare, OJF-të, të rinjtë, gratë, media zhvillojnë aktivitetet në QEK dhe kanë hapësirat e duhura.

## Aktivitetet e projektit

- 1 Zgjedhja e organeve drejtuese
- 2 Hartimi i planit vjetor me pjesëmarrjen e grupeve të interesit
- 3 Akomodimi i OJF (që nuk kanë zyra dhe kanë nga një vend pune) dhe medias në ambientet e QEK
- 4 Hapja e kurseve artistike në QEK
- 5 Aktivitete rinore (individuale, grupe të vogla, grupe të mesme dhe grupe të mëdha) organizohen çdo javë në QEK
- 6 Aktivitete për shoqërinë civile, debate publike, konferenca shkencore dhe studime të ndryshme, takime me intelektualë, promovime librash, ngjarje historike, figura të shquara, etj., mbahen në ambientet e QEK
- 7 Konkurse, ekspozita dhe panairë
- 8 Fond konkurues për aktivitete i vënë në dispozicion nga Bashkia.

## Maturimi i projektit

Qendra është eksperiencë Daneze nga DANIDA. Gjithashtu ajo ka punuar dhe me SNV dhe programin CARDS. Modelet dhe udhëzimet janë aktuale, ekzistojnë hapësirat e duhura, si dhe njerëz që kanë punuar dhe punojnë për qendrën.

## Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Burimet e financimit do të jepen nga Bashkia, pasi Qendra është pjesë organike e saj. Aktualisht bashkia mbulon pagat e personelit dhe shpenzimet për mirëmbajtjen dhe funksionimin e godinës. Për shumë aktivitete dhe për një projekt mund të gjenden edhe donatorë të ndryshëm, që kanë në fokus demokratizimin, pjesëmarrjen qytetare dhe çështjet sociale.

## Kostot e projektit

Kostoja e projektit është afërsisht 15,000 Euro.